

PROCESVERBAL
nga seanca e 7-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 28.02.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 7-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski informoi se Rendi i ditës i propozuar do të korrigjohet sepse do të futen (barten) tri pika të reja dhe atë: Pika 5 - Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR GALAKSI – 2002 Kavadar , Pika 6 - Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR TV – EDO Saraj dhe Pika 7 - Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR T. V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi korrigjimin e mëposhtëm të:

RENDIT TË DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtura më 19.02.2024.
2. Raportoin për llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023 me Propozim-vendim për miratimin e llogarisë vjetore.
3. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për HIT RADIO Strumicë.
4. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për RADIO RED FM Tetovë.
5. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR GALAKSI – 2002 Kavadar.
6. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR TV – EDO Saraj.
7. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR T. V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë .

8. Informacion për ndërprerje të procedurave me kërkesë për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor në nivel lokal për arsye të shpalljes së zgjedhjeve për vitin 2024, me Propozim- Njoftime.
9. Të ndryshme

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 6-të e Këshilli të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 19.02.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski e shpjegoi Raportin e propozim për llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023 me Propozim-vendim për miratimin e llogarisë vjetore. Ai ka shpjeguar se Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në përputhje me Ligjin për Kontabilitet për Organizatat Jofitimprurëse, e dorëzoi llogarinë vjetore për vitin 2023, jo më vonë se 29 shkurti i vitit aktual. Të hyrat totale të realizuara në vitin 2023 arrijnë në 97.085.706,00 denarë. Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave, gjegjësisht 54.351.919,00 denarë, që paraqet 55,98% të të hyrave të përgjithshme, janë për financimin e veprimtarisë radiodifuzive nga Buxheti i RMV-së (d.m.th. 54.000.000,00 denarë) dhe taksë radiodifuzive e paguar nga vitet e kaluara në shumën prej 351.919,00 denarë. Financimi mbi këtë bazë edhe në vitin 2023 është në përqindje më të ulët se ajo e përcaktuar në Ligj. Me ndryshimet ligjore që kanë hyrë në fuqi më 28 korrik 2023, duke filluar nga muaji gusht 2023, nga buxheti i RMV-së duhej të ndahen mjete për financimin e veprimtarisë së transmetimit në masë 1% të realizuara nga të hyrat tatimore të përcaktuara në llogarinë përfundimtare të miratuar të buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga e cila 5% janë dedikuar për financimin e Agjencisë. Megjithatë, ai sqaroi se për muajt gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2023, në muaj në Agjenci janë transferuar 4.500.000,00 denarë, në vend të 5.237.054,00 denarë. Domethënë për periudhën 5 mujore janë paguar më pak mjete nga ato të parapara me ligj për 3.685.270,00 denarë. Ai tha se për atë arsye Agjencia në vitin 2024 ka paraqitur padi në gjykatën kompetente për pagesën e mjeteve në përqindje të përcaktuar me dispozitë ligjore. Sipas Vendimit për ndihmë financiare (donacion), kompensimi vjetor i lejes për transmetuesit për vitin 2023 është ulur për 25%. Nga lejet për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive janë realizuar të hyra gjithsej 30.931.171,00 denarë, ndërsa nga mbikëqyrja e ritransmetimit të shërbimeve programore dhe shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë janë realizuar të hyra prej 10.620.245,00 denarë. Pjesa tjetër e të ardhurave është realizuar nga fatura tranziti në shumën prej 1.045.762,00 denarë, të hyra tjera në vlerë prej 135.583,00 denarë dhe nga diferenca pozitive të kursit të këmbimit në vlerë prej 1.026,00 denarë. Gjithsej shpenzimet e realizuara në vitin 2023 arrijnë në 111.337.058,00 denarë. Shpenzimet më të mëdha janë për pagesën e pagave bruto për të punësuarit në shërbimin profesional, në vlerë prej 60.550.025,00 denarë, që paraqet 54,38% nga gjithsej shpenzimet. Shpenzimet tjera më të mëdha kanë të bëjnë me kompensimet për anëtarët e Këshillit të Agjencisë në shumë prej 10.331.245,00 denarë, për servisimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të Agjencisë në shumë prej 8.640.590,00 denarë, shpenzimet për energjinë

elektrike dhe termike të konsumuar në vlerë prej 3.131.709,00 denarë, për blerje të DMS (Document Management System) dhe Firewall, janë shpenzuar mjete në vlerë prej 6.268.968,00 denarë dhe shpenzime për punësimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm përmes Agjencisë për punësim të përkohshëm, për angazhimin e agjencisë për përkthim, për mirëmbajtjen e higjienës në ambientet afariste në shumë prej 4.574.035,00 denarë. Shpenzimet totale të realizuara janë më të ulëta se shpenzimet e planifikuara të pozicioneve të specifikuar të miratuara në Planin Financiar për vitin 2023. Kërkesat totale të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale sipas llogarisë vjetore për vitin 2023 arrijnë në 3.150.728,00 denarë dhe më së shumti i referohen faturave të lëshuara në vitet e kaluara. Gjithsej detyrimet që i ka Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ndaj kreditorëve sipas llogarisë vjetore për vitin 2023 janë 2.057.137,00 denarë. Këto borxhe i referohen detyrimeve të prapambetura, të cilat kryesisht janë paguar në muajin janar 2024. Vlera kontabël e mjeteve (aseteve) bazë në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në fund të vitit 2023 është 277.644.417,00,00 denarë. Në vitin e ardhshëm 2024 do të transferohen mjete në vlerë të përgjithshme prej 127.981.020,00 denarë.

Z. Petrushevski tha se do të bëjë një pyetje të drejtpërdrejtë që nuk ka të bëjë me Raportin, por në lidhje me diskutimin e drejtorit nga një seancë e kaluar kur tha se ka pasur një zhvendosje të vogël pozitive, se ka pasur pagesa të caktuara nga MIOA në llogari të Agjencisë. Ai pyeti nëse pagesat nga ministria vazhdojnë në drejtim pozitiv apo statusi është ndryshe?

Z. Trajçevski shpjegoi se nuk ka ndryshim nga hera e fundit që ka pasur pagesë deri më sot. Por duhet parë nga nesër se kur ministria duhet të transferojë mjete. Ka njoftime verbale nga ministri i ri se do të vazhdojnë me plotësimin e mjeteve që i takojnë ASHMA-së sipas Ligjit, por cili do të jetë trendi i pagesës, nëse do të vazhdojë ministria me pagesën, do të shihet javën e ardhshme.

Z. Petrushevski tha se rezultati financiar do të ishte edhe më i favorshëm nëse mjetet paguhen rregullisht nga MIOA siç është shkruar në ligj. Por ana e mirë është se Agjencia ka kursyer mjete nga vitet e kaluara dhe se ato nuk janë shpenzuar në mënyrë të paarsyeshme. Me këtë përfitohet njëfarë sigurie për Këshillin dhe mbi të gjitha për të punësuarit. Në çdo rast, Agjencia duhet të vazhdojë dhe më tej të kërkojë të drejtat e saj siç janë shkruar në Ligj, për të ardhmen e Agjencisë në përgjithësi. Situata financiare nuk është ende e keqe, por nëse vazhdohet kështu do të duhet të shpenzohen mjetet (fondet) e viteve të kaluara. Ai deklaroi se do ta mbështesë Raportin, personalisht është i kënaqur me mënyrën se si punon Agjencia, drejtori dhe shërbimi, me kursim maksimal si gjithmonë dhe beson se kështu do të vazhdojë.

Z. Fidanoski tha se është i kënaqur me njoftimin e drejtorit Trajçevski se do të vazhdojë trendi i pagesës së mjeteve që i ka borxh MIOA ndaj ASHMA-së, se ato do të paguhen në përputhje me ligjin. Ai tha se do të mbështesë Raportin. Ai theksoi se Agjencia, ndryshe nga institucionet dhe organet e tjera shtetërore që ende nuk kanë miratuar llogarinë përfundimtare për vitin 2022, siç është llogaria përfundimtare për buxhetin qendror, ASHMA miraton llogari për vitin 2023, që do të thotë se po e kryen punën e saj ashtu siç është dhe duhet. Nëse do të miratohej llogaria përfundimtare për buxhetin qendror për vitin 2022, ato 62 milionë denarë që i takojnë Agjencisë nga buxheti, sipas vlerësimit të tij të përafërt, do të ishin 6-7 milionë denarë më shumë, që do të thotë më shumë mjete do të duhej të paguhen. Ai nuk dëshiron të spekulojë nëse është bërë me dashje apo jo, por pret që dhe institucionet e tjera të punojnë me aq zell sa Agjencia. Ai shpjegoi se i ka shqyrtuar pikat nga Raporti për llogarinë vjetore të Agjencisë për vitin 2023 dhe është i kënaqur me faktin se janë më të vogla se sa ishte

planifikuar, që do të thotë se është bërë punë ekonomike dhe beson se do të vazhdojë në atë kontekst.

Z. Ajdini tha se sipas shifrave të dhëna shihet se Agjencia ka kapacitet financiar që të vazhdojë t'i përmbush edhe më tej detyrimet e dhëna në ligj. Ai beson se trendi i pagesave nga MIOA do të vazhdojë edhe më tej. Në të kaluarën ka pasur disa vështirësi me pagesën, por ai ende beson se ASHMA-ja mund të vazhdojë në mënyrë të pavarur dhe autonome të përmbushë detyrimet e saj ligjore. Ai deklaroi se do të mbështesë Raportin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri pranoi Raportin për llogarinë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizualee për vitin 2023 nr. 0501-1009/1 datë 26.02.2024 dhe njëzëri miratoi Vendim për miratimin e Llogarisë vjetore të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizualee për vitin 2023.

Në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Kontabilitet për Organizatat Jofitimprurëse, llogaria vjetore dorëzohet te Drejtoria e të Hyrave Publike dhe tek Regjistri i Llogarive Vjetore pranë Regjistrat Qendror deri në fund të muajit shkurt të vitit të ardhshëm.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm duhet ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7

Z. Petrushevski propozoi që për të pesë pikat të bëhet një hyrje dhe diskutim i përbashkët dhe më pas të votohet për secilën prej tyre veç e veç.

Këshilli nuk kishte kundërshtim.

Z. Trajçevski shpjegoi se të pesë transmetuesit, për të cilët është inicuar procedura për heqjen e lejes, në afatin shtesë e kanë paguar kompensimin në tërësi (plotësisht). Për këtë arsye propozohet ndërprerja e procedurave.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive HIT RADIO SHPKNJP Strumicë, PA 1 nr.08-128 e datës 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesë të kryer me nr.0503-789/2 datë 22.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive HIT RADIO SHPKNJP Strumicë, kompensimin vjetor për transmetim në radio e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0071 të datës 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë , PA1 1 nr.08-133 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.0503-790/2 datë 23.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0076 të datës 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë..

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Akvendim për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive GALAKSI-2002 SHPKNJP Kavadar, PA1 nr.08-100 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për kryerjen e pagesës me nr.0503-788/2 datë 27.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive GALAKSI-2002 SHPKNJP Kavadar, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0053 datë 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë..

Votimi sipas pikës 6

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Akvendim për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-EDO SHPKNJP fsh. Ljubin, Saraj, PA1 nr.08-14 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për kryerje të pagesës me nr.0503-787/2 datë 27.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV-EDO SHPKNJP, fsh. Ljubin, Saraj, kompensimin vjetor për lejen për transmetim televiziv e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0008 , datë 11.01.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb fqen e Agjencisë. .

Votimi sipas pikës 7

Këshilli i Agjencisë ka marrë Vendim për ndërprerjen e procedurës së iniciuar për heqjen e lejes për transmetimteleviziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive T. V. KALTRINA Mazar Tateshi , Strugë SHPKNJP, PA1 nr.08-55 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.0503-782/2 datë 27.02.2024, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive T.V KALTRINA Mazar Tateshi, Struga SHPKNJP, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv e ka paguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar me nr. 2024-100-0018, datë 11.01.2024 .

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshilli, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb fqen e Agjencisë. .

Z. Petrushevski pas votimit tha se shpreson që këtë vit kushtet kushtet financiare për transmetuesit të jenë më të mira për shkak të zgjedhjeve të vitit 2024 dhe vitin e ardhshëm nuk do të jenë në situatën e njëjtë që të inicojnë procedura për heqjen e lejeve.

Pika 8

Z. Trajçevski shpjegoi Informacionin e propozuar për ndërprerje të procedurave me kërkesë për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal për arsye të shpalljes së zgjedhjeve në vitin 2024 , me Propozim-Njoftimet. Ai ka shpjeguar se ka dy kërkesa të paraqitura nga palët e interesuara, për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e qytetit të Manastirit dhe qytetit të Tetovës. Por për shkak të zgjedhjeve të shpallura 2024, propozohet ndërprerja e procedurave pas dy kërkesave me shkrim deri në zgjedhjen e kryetarit të RMV-së, deputetëve në Kuvendin e RMV-së dhe zgjedhjes së Qeverisë së RMV-së në vitin 2024, në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, pas së cilës ato duhet të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë miratoi Informacionin nr.0803-680/3 datë 26.02.2024 dhe njëzëri miratoi Konkluzion për ndërprerjen e procedurave pas dorëzimit të 2 (dy) kërkesave me shkrim nga palët e interesuara, për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e qytetit të Manastirit dhe qytetit të Tetovës deri në përfundim të zgjedhjeve për kryetar të RMV-së, deputetë në Kuvendin e RMV-së dhe zgjedhjen e Qeverisë së RMV-së në vitin 2024, sipas rezultateve të zgjedhjeve, pas së cilës të njëjtit ë vazhdojnë në pajtim me dispozitat e LSHMAAV.

Për konkluzionit të miratuar të njoftohen parashtuesit e kërkesave, si dhe palët e interesuara për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e qytetit të Manastirit – Personit juridik Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime eksport-import KAMAJ MEDIA SHPKNJP Manastir dhe për zonën e qytetit të Tetovës, personi fizik Blerim Jakupi nga Tetova.

Pas përfundimit të zgjedhjes së Kryetarit të RMV-së, deputetëve në Kuvendin e RMV-së dhe zgjedhjes së Qeverisë së RMV-së në vitin 2024, në përputhje me rezultatet e zgjedhjeve, të kërkohet nga palët e interesuara të deklarojnë nëse kanë ende interes për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e qytetit të Manastirit dhe qytetit të Tetovës.

Pas votimit, z. Trajçevski shpjegoi se teorikisht mund të ndodhë që AKE-ja të përgjigjet se nuk ka frekuenca të lira, por gjithsesi procedurat do të vazhdojnë pas zgjedhjeve.

Pika 9

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**